



NJOFTIM PËR HAPJEN E KONKURSIONIT: SË BASHKU, PËR BARAZINË DHE KUNDËR DHUNËS!

Bashkia Himarë në prag të **fushatës ndërkombëtare të “16 Ditëve të Aktivizimit” kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje**, në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Vendore, si dhe me Drejtorinë e të gjitha shkollave të territorit të Bashkisë, njofton hapjen e konkursit me temë: **“Së bashku, për barazinë dhe kundër dhunës!”** Në këtë konkurs ftohen të gjithë nxënëset dhe nxënësit e shkollave të Himarës të përgatisin krijimet e tyre për të dhënë mesazhe kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në komunitetin tonë. Punimet e nxënësve dhe nxënësve, duhet të dorëzohen pranë drejtorisë së shkollave **deri në datën 25 nëntor, ora 13.00.**

Punimet, do të vendosen të gjitha **në faqen e internetit të bashkisë Himarë**, ku nga **data 26 nëntor – 9 dhjetor** do të hapet edhe votimi (on-line) vetëm për prindërit, mësueset dhe mësuesit, si dhe për familjarët e të afërmit e nxënësve dhe nxënësve që po konkurrojnë (pra votimi do të hapet për mbarë komunitetin por mbi moshën 18 vjeç). Mënyra e votimit do të jetë nëpërmjet “Like”, “Koment” dhe “Share” vetëm nga dhe tek faqja zyrtare e Bashkisë Himarë.

Shpallja e fituesve dhe fituesve do të bëhet **në datën 10 Dhjetor** bazuar në votimet dhe komentet on-line vetëm përmes faqes zyrtare të Bashkisë Himarë, si dhe bazuar në mendimet e një komisioni të përbërë nga përfaqësues dhe përfaqësues nga Bashkia dhe Zyra Arsimore Vendore.

Nxënëset dhe nxënësit që do të fitojnë çmimet e para me krijimet e tyre në secilën fushë të artit, do të ftohen pranë institucionit të Bashkisë Himarë në një aktivitet në fund të vitit, ku do të nderohen nga Nënkrjetarja e Bashkisë znj. Blerina Bala, edhe me një certifikatë mirënjohjeje, ndërkohë që punimet fituese do të afishohen pranë institucionit të Bashkisë, shkollave përkatëse dhe Zyrës Arsimore Vendore.

Ky aktivitet organizohet nga Bashkia Himarë, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë z. Jorgo Goro dhe mbështetet nga UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara, "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzve", financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.